



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
ASAMBLEJA

Prot 718/3

Tiranë, 16.10.2023

Vendim nr. 57 datë 16.10.2023

**Për dhënien e titullit *anëtar nderi* të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë prof. Joseph Wang**

Mbështetur në nenin 6 pika 3 të Ligjit 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*;

Referuar nenit 12 pika 1 të *Statutit* të Akademisë së Shkencave dhe nenit 12 pika 5 të *Aneksit II* të tij;

Me propozim të Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike, mbështetur në kërkesën e relacionet me shkrim të dy anëtarëve të Asamblesë: akad. Arben Merkoçit në emër të njësisë *NanoAlb* (bashkëngjitur) dhe akad. asoc. Besnik Baraj në emër të njësisë *për pasuritë ujore* (bashkëngjitur);

Pas dhënies së pëlqimit të tyre nga anëtarësia e dy seksioneve sipas parashikimit në pikën 3 të nenit 12 të *Statutit* për procedurat statutore për vendimet qarkulluese (procesverbali bashkëngjitur);

Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Vendosi

1. T'i japë titullin *anëtar nderi* të kësaj Akademie z. Joseph Wang, profesor i shquar me njohje ndërkombëtare, personalitet në disiplinat e

reja të shkencës botërore si inxhinieria biomjekësore, nanoinxhinieria, elektrokimia, biosensorët dhe nanomakinertë, me këtë

### Motivacion

*Për meritat e tij të veçanta si paraprirës në kërkim dhe në aplikime të suksesshme në dijet më të reja si nanoshkenca e nanoteknologjia dhe rritjen e rolit të këtyre shkencave në shkallë globale; si një prej nxitësve e frymëzuesve të themelimit të nanoteknologjisë analitike në vendin tonë; duke ndikuar fort për rritjen e prestigjit dhe të performancës së njësisë “Nano-Alb” në mjedise ndërkombëtare; në mënyrë të veçantë për themelimin në Shqipëri e në Kosovë të disiplinave universitare dhe kërkimore në fushën e elektrokimisë dhe nanoteknologjisë së sensorëve; i vlerësuar me stimë të lartë si mik e koleg nga kërkuesit shqiptarë në fushën e analizës elektrokimike dhe nanoteknologjisë dhe me një rol prej protagonistit për përgatitjen dhe zhvillimin cilësor të kongresit të tretë të nanoshkencës organizuar në Tiranë, i njohur më gjerë me shkurtesën “Nano-Balkan-2023 Congress”.*

2. Ceremonia e dorëzimit të diplomës së anëtarit të nderit të organizohet më datën 16.10.2023, në kuadër të kongresit të tretë të nanoshkencës Nano-Balkan-2023, në përputhje me pikën 4 të nenit 12 të Statutit dhe me Rregulloren për ceremonitë dhe solemnitetet të Akademinë e Shkencave.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

